



Planuar / Doretuar Punëjoni/Produkti Received/Deliverty	20.04.2023	3 viti god year	
Organ /Njësia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojça Prilog Appendix	Sasia Kohësina Quantity
SKAMSHUK	3720/2023		115



## Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.373/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetar, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.373/2023 të datës 20.02.2023 e parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar avokati \_\_\_\_\_ për ankuesin \_\_\_\_\_ me adresë:

\_\_\_\_\_, kundër organit të punësimit Ministria e Punëve të Brendshme-Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 20.04.2023, mori këtë:

### V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.373/2023 e datës 20.02.2023 e parashtruar nga ankuesi

II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër Nr.2775/2022 i datës 28.12.2022 i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

### A r s y e t i m

Ankuesi \_\_\_\_\_, me datë 20.02.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 1883/2023 përmes përfaqësuesit të autorizuar avokatit \_\_\_\_\_ nga Prishtina, e regjistruar me numër A.nr.373/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, kundër Vendimit Nr.2775/2022 të datës 28.12.2022 të Zëvendës Drejtores së Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 06.03.2023 ka dërguar kërkesën për



përgjigje në ankesë të ankuesit në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë. Këshilli me datën 29.03.2023 ka pranuar përgjigje në ankesë me provat e bashkangjitura të lëndës.

Sipas kërkesës të datës 03.04.2023 të Kryetares së Kolegjit, me datë 04.04.2023 Kryetari i Këshillit ka nxjerrë Vendimin VK/2023 me numër protokoll: 3287/2023 përmes të cilit ankesës së ankuesit A.nr.373/2023 të datës 20.02.2023 i ka vazhduar afatin vendimmarrës edhe për dhjetë (10) ditë të punës.

*Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka administruar këto prova:* Ankesën e datës 20.02.2023 e parashtrua në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Kosovës, me numër protokoll 1883/2023 e regjistruar me numër rendor A.nr.373/2023; Vendimin me numër Nr.2775/2022 i datës 28.12.2022 i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik në Ministrinë e Punëve të Brendshme; kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 06.03.2023; E-mailin e datës 29.03.2023 dërguar nga Këshilli për \_\_\_\_\_; Përgjigjen në kërkesë me shkresat e lëndës të datës 03.04.2023; Shkresën përcjellëse të datës 31.03.2023; E-mailin e datës 29.12.2022 dërguar nga arkiva.map për ankuesin; E-mailin e datës 30.03.2023 dërguar nga \_\_\_\_\_ për \_\_\_\_\_ me shkresat e bashkangjitura të korrespondencës; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën "Drejtor i Muzeut Shtetërore të Kristaleve dhe Mineraleve-Trepça"; Diplomën e ankuesit të datës 24.06.1998; Diplomën e ankuesit të datës 28.02.2012; Ankesën e datës 13.10.2022 e parashtrua në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Kosovës, me numër protokoll 6141/2022 e regjistruar me numër rendor A.nr.903/2022, përmes përfaqësuesit të autorizuar avokatit \_\_\_\_\_ nga Prishtina sipas Autorizimit të datës 31.12.2021; Vendimi me numër A.nr.341/2022 i datës 12.09.2022 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Kosovës; Vendimi Nr.1433/2022 i datës 29.09.2022 i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik në Ministrinë e Punëve të Brendshme; Tabela e datës 07.10.2022 e nxjerrë për linjën e transportit të autobusit Mitrovicë-Stantërg-Bajgorë prej 1/3 faqe; Tabela e datës 07.10.2022 e nxjerrë për linjën e transportit të autobusit Dobraj-Poturoc-Prishtinë prej 1/3 faqe; E-maili i datës 05.10.2022 zyrtar lidhur me respektimin e orarit të punës, nga Zyra e zv. Kryeshefit Ekzekutiv të SHGJK; fotografi e hartës së Kosovës, destinacioni dhe largësia nga vendbanimi i ankuesit deri tek vendi i punës, e nxjerrë nga Googel Map; Përgjigje në ankesë e datës 11.11.2022 nga Zyrtari për zhvillim të rekrutimit /MPB; E-mail i datës 07.11.2022 mbi pranimin e vendimit nr. 1433 të datës 29.09.2022; Diploma Universitetit e datës 28.02.2012 Nr.51 e ankuesit; me titullin Master i shkencave teknike; Diplomë Universitetit të Prishtinës e datës 24.06.1998 Fakulteti i Xehetarisë dhe Metalurgjisë; Certifikatë e datës 28.04.2010 e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës mbi magjistraturën e shkencave teknike, e noterizuar me datë 27.03.2013 me numër ref.LRP.3338/13; CV-e ankuesit, lidhur me vendbanimin, përgatitjen arsimore/universitare dhe përvojën e punës; E-mail i datës 09.11.2022 nga Zyrtari për zhvillim të rekrutimit /MPB, drejtuar znj. \_\_\_\_\_, me kërkesë lidhur me vendbanimin e ankuesit; Emil i datës 09.11.2022 përgjigje nga znj. \_\_\_\_\_ lidhur me kërkesën e Zyrtarit për zhvillim të rekrutimit /MPB.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar janë përmbushur kushtet ligjore që lënda të kthehet në rivendosje, *sepse:*

Nga shkresat e administruara të lëndës Kolegji i Këshillit ka gjetur se ankuesi sipas vendimit Nr.03/117 të datës 22.01.2020 ka qenë i emëruar në pozitën Drejtor i Përgjithshëm i Shërbimit Gjeologjik të Kosovës, ndërsa Qeveria e Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur me datën 29.12.2021 ka nxjerrë Vendimin me numër Nr.31/52 përmes të cilit ka shfuqizuar vendimin Nr.03/117 të datës 22.01.2020.



Pas shqyrtimit në procedurë administrative të lëndës së ankuesit, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës përfundimisht me datë 12.09.2022 ka nxjerrë Vendimin me numër A.nr.341/2022 me të cilin e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar ankesën e ankuesit, duke e lënë në fuqi Vendimin numër Nr.13/52 të datës 29.12.2021 të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe duke obliguar Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme/DMZP-në që ankuesit t'i bëjë kompensimin në mënyrë retroaktive të pagave nga dita e shkarkimit deri në momentin e zbatimit të këtij vendimi konform legjislacionit në fuqi si dhe po ashtu ka obliguar Drejtorin e Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik në Ministrinë e Punëve të Brendshme, për zbatimin e këtij vendimi, brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit, duke e sistemuar ankuesin në pozitë të mesme drejtues në shërbimin civil në pajtim me legjislacionin në fuqi, gjegjësisht sikurse përcaktohet me nenin 42 paragrafi 7 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik.

Me qëllim të zbatimit të Vendimit A.nr.341/2022 të datës 12.09.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 29.09.2022 Zëvendësuesja Drejtorja e Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik në Ministrinë e Punëve të Brendshme ka nxjerrë Vendimin Nr.1433/2022 me të cilin ankuesin e ka sistemuar në pozitën "*Drejtor i Muzeut Shtetëror të Kristaleve dhe Mineraleve-Trepça*", në Shërbimin Gjeologjik të Kosovës, në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë, me seli në fshatin Stantërg në Komunë të Mitrovicës, në pajtim me nenin 42 paragrafin 7 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik si dhe disponueshmërisë së vendit të lirë të punës në Ministrinë e Ekonomisë dhe përgatitjes profesionale si dhe përvojës së punës së kaluar në shërbimin civil të republikës së Kosovës.

Ndërsa, ankuesi me datë 13.10.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër Nr.1433/2022 të datës 29.09.2022 të Zëvendësues së Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, me pretendimin ankimor se i njëjti me rastin e sistemimit në pozitë "*Drejtor i Muzeut Shtetëror të Kristaleve dhe Mineraleve-Trepça*", në Shërbimin Gjeologjik të Kosovës, në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë, në Stantërg - Mitrovicë është me tepër se 140 km (vajtje ardhje), nga vendbanimi i tij, gjegjësisht nga fshati Poturoc i Komunës së Lipjanit. Po ashtu ankuesi pretendon që ti bëhet e mundur që ti ofrohet vendi punës të lira të kategorisë së mesme drejtuese, në një lokacion të përshtatshëm, që të mund ti kryejë detyrat dhe përgjegjësitë e punës që i përgjigjet distanca fizike por dhe të përvojës dhe përgatitjes profesionale të tij në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit, ka shqyrtuar Vendimin numër Nr.1433/2022 të datës 29.09.2022 të Zëvendësues së Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, dhe si rrjedhojë ka gjetur se vendimi për emërimin e ankuesit në pozitë "*Drejtor i Muzeut Shtetëror të Kristaleve dhe Mineraleve-Trepça*", në Shërbimin Gjeologjik të Kosovës, në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë, në Stantërg - Mitrovicë, është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenin 48 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 dhe 1.6, ku përcaktohet se: 1. *Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban: 1.3 shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave; 1.6. në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në vendim*", ndërsa Këshilli përmes Vendimit A.nr.903/2022 të datës 13.12.2023 ka aprovuar ankesën e ankuesit të datës 13.10.2022, kurse e ka shfuqizuar Vendimin Nr.1433/2022 të datës 29.09.2022 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik për shkak të arsyetimit të



pamjaftueshëm. Tutje Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik me qëllim të zbatimit të vendimit të Këshillit ka rishqyrtuar rastin e ankuesit dhe ka nxjerr Vendimi me numër Nr.2775/2022 i datës 28.12.2022 i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik në Ministrinë e Punëve të Brendshme përmes të cilit ankuesin e ka sistemuar në pozitën *“Drejtor i Muzeut Shtetërore të Kristaleve dhe Mineraleve-Trepça”* në Shërbimin Gjeologjik të Kosovës, në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë.

Me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat ligjore të nenit 15 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores NR.15/2020 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues ku përcaktohet se: *“1. Pas përfundimit të mandatit të nëpunësit, DMZP për institucionet e administratës shtetërore dhe NJBNJ për institucionet tjera shtetërore e emëron nëpunësin në një pozitë të kategorisë së mesme drejtuese nëse ka të lirë një pozitë të tillë, e nëse nuk ka të lirë atëherë e emëron në një pozitë të nivelit më të lartë të kategorisë profesionale. 2. Refuzimi për t’u emëruar në pozitën e nivelit të mesëm drejtues ose profesional është shkak për lirin nga Shërbimi Civil dhe përfundimin e marrëdhënies së punës të nëpunësit”*, dhe po ashtu në këtë kuptim ka analizuar edhe përshkrimin e detyrave të punës të datës 16.04.2015 për pozitën *“Drejtor i Muzeut Shtetërore të Kristaleve dhe Mineraleve-Trepça”* lidhur me kushtet dhe kriteret e përgjithshme formale që duhet plotësuar kandidati me qëllim të ushtrimit të kësaj pozite dhe ka gjetur se duhet të plotësohet kriteri si në vijim: *“Diplomë Universitare në lëmin përkatëse-Inxhinier i diplomuar i Gjeologjisë ose Master i Gjeologjisë si dhe Minimumi 7 vite përvojë pune..”*

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji i këshillit ka gjetur se ankuesi posedon Diplomën e datës 24.06.1998 përmes të cilës dëshkohet se i njëjti ka mbaruar studimet në, Fakultetin e Xehetarisë dhe Metalurgjisë në Universitetin e Prishtinës, po ashtu posedon Diplomën Nr.51 e datës 28.02.2012 përmes të cilës dëshkohet se i njëjti me datë 28.04.2010 ka mbaruar studimet post diplomike në Fakultetin e Xehetarisë dhe Metalurgjisë në Mitrovicë, në kuadër të Universitetit të Prishtinës, prandaj mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit vlerëson se Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik me rastin e nxjerrjes së vendimit me numër Nr.2775/2022 i datës 28.12.2022 përmes të cilit ankuesin e ka sistemuar në pozitën e punës *“Drejtor i Muzeut Shtetërore të Kristaleve dhe Mineraleve-Trepça”* ka vepruar në pajtueshmëri me dispozitat e ligjit material gjegjësisht në frymën e nenit 42 paragrafi 7 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ndërlidhur me frymën e përcaktuar të pranimit dhe emërimit në Shërbimin Civil sipas Rregullores Nr. 16/2020 Për Pranimin Dhe Karrierën Në Shërbimin Civil Të Republikës Së Kosovës, pasi që nuk mund të emërohesh në një pozitë në kuadër të Shërbimit Civil nëse paraprakisht nuk i plotëson kushtet dhe kriteret e kërkuara të asaj pozite, pasi që Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik në arsyetimin e Vendimit me numër Nr.2775/2022 të datës 28.12.2022 e ka specifikuar arsyen e sistemimit të ankuesit në këtë pozitë, pasi që ka qenë kjo pozitë e lirë kriteret e së cilës ankuesi i ka plotësuar sa i përket përgatitjes së tij profesionale dhe përvojës së punës.

Ndërlidhur me pretendimin ankimor të ankuesit sa i përket distancës ndërmjet vendbanimit të ankuesit dhe vendit të punës, Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat e nenit 52 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë ku përcaktohet se: *“1. Nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozitë tjetër të Shërbimit Civil të së njëjtës kategori, në këto raste: 1.1. kur është në interes të institucionit, deri në 6 muaj gjatë 2 vjetëve; 1.2. për përmirësimin e rezultateve të vetë nëpunësit, deri në 3 muaj gjatë 2 vjetëve; 1.3. për arsye të përkohshme shëndetësore në bazë të vendimit të komisionit kompetent, sipas ligjit, për aq sa është e nevojshme, sipas vendimit të komisionit përkatës; 3. Nëpunësi civil mund të refuzojë transferimin në këto raste: 3.1. kur gjendja e tij shëndetësore, provuar me vërtetim mjekësor, e bën transferimin të pamundur; 3.2. nëse vendi ku transferohet gjendet më shumë se 100 km nga vendbanimi i nëpunësit civil.”*,



dhe ka ardhur në përfundimin se ankuesi gabimisht ka bërë interpretimin e dispozitave të ligjit material, ngase dispozitave ligjore që ankuesi iu referohet kanë të bëjnë institutin e transferimit të përkohshëm në kuadër të Shërbimit Civil, ndërsa kujtojmë faktin se ankuesi në rastin konkret nuk është transferuar përkohësisht, por i njëjti përmes Vendimi me numër Nr.2775/2022 i datës 28.12.2022 është sistemuar në mënyrë të përhershme në kuadër të Shërbimit Civil sikurse përcaktohet me nenin 42 paragrafi 7 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, nga rrjedh se pretendimi ankimor i ankuesit në rastin konkret është i pabazuar.

Prandaj nga se u tha si më lartë, Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, analizimit të dispozitave të ligjit material dhe shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit, si dhe arsytimit të dhënë në këtë vendim, ka ardhur në përfundimin se ankesa e ankuesit është e pabazuar dhe si e tillë është refuzuar si në dispozitiv të këtij vendimi, ndërsa Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik me rastin e nxjerrjes së vendimit me numër Nr.2775/2022 i datës 28.12.2022 ka vepruar në pajtueshmëri me dispozitat e ligjit material gjegjësisht në frymën e nenit 42 paragrafi 7 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

## KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.373/2023

Flakron GASHI

Procesmbajtës

Malsore Gashi BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit



### Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar
- Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në MPB;
- Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Gjeologjik të Kosovës, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.